



KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK - MUNICIPALITY OF KACANIK

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

DHJETOR 2023



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (PGA), në komunën e Kaçanikut përkatësisht në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), janë identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimi është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengoj gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Kaçanikut me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori dy ditore më 14 dhe 15 Dhjetor 2023, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Kaçanikut dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastrë, Grupi II–Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DUKMM. Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

PGA në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Kaçanikut në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DUKMM Kaçanik, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
DAP	Drejtoria e Administratës Publike
DZHE	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
KK	Kuvendi Komunal
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LK	Ligji për Kadastër
LKPP	Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LRDPP	Ligji për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
RDPP	Regjistri i Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ
ZBGJ	Zyra për Barazi Gjinore

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA KAÇANIK

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUGJETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Funksionalizimi i sportelit	1.1	Të angazhohet një zyrtar i përhershëm për punë në sportel, preferohet të jetë jurist.	1. Kërkesa nga Drejtori tek zyra e burimeve njerëzore (zyra e personelit). 2. Hapja e konkursit dhe procedurat e prokurimit	ZKK dhe Zyra e personelit	545 euro për muaj	Q2-2024	Mos aprovimi i kërkesës
		1.2	Në sportel duhet të vendosen pajisjet teknologjike (kompjuterë, skanerë dhe printer)	Kërkesa nga Drejtori tek Drejtoria e Administratës	ZKK dhe DAP, Operatori Ekonomik i angazhuar nga AQP	1. 750 euro për një kompjuterë. 2. Printer dhe skanerët sigurohen me kërkesë tek kompania e kontraktuar nga AQP	Q2-2024	Vonesa në furnizim
		1.3	Të vendoset lista e dokumentacionit të nevojshëm për lëndët e caktuara kadastrale	Dizajnimi dhe printimi i listës së dokumentacioneve	ZKK, AKK dhe PGA	-	Q2-2024	Nuk parashihen rreziqe
		1.4	Në sportelin e ZKK-së duhet të ketë fletëpalosje informuese për produktet dhe shërbimet kadastrale.	Dizajnimi dhe printimi i fletëpalosjeve	ZKK, AKK dhe PGA	1,500-2,000 euro	Q2-2024	Nuk parashihen rreziqe
2	Mungesa e zyrës pritëse	2.1	Të krijohet zyra pritëse	Kërkesa nga Drejtori i ZKK-së tek DAP dhe Kryetari për shfrytëzimin e zyrës ngjitur me ZKK-në respektivisht zyrën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik	ZKK, DAP, zyra e Kryetarit, DZHE	500 euro	Q4-2024	Mos aprovimi i kërkesës
		2.2	Në zyrën pritëse duhet të vendosen pajisjet teknologjike si kompjuterë dhe printer	Kërkesa nga Drejtori tek Drejtoria e Administratës dhe kompania mirëmbajtëse për printer	ZKK, DAP dhe OE	1. 750 euro për një kompjuterë. 2. Printeri sigurohet me kërkesë tek kompania e kontraktuar nga AQP	Q4-2024	Mos aprovimi i kërkesës

3	Hapësira e vogël në zyrën kryesore të punës	3.1	Zgjerim i hapësirës së punës	Hapësira e zyrës ngjitur me ZKK për krijimin e zyrës pritëse, një pjesë të shfrytëzohet si zgjerim i hapësirës për zyrë kryesore të punës	ZKK, DAP, zyra e Kryetarit, DZHE	-	Q4-2024	Mos aprovimi i kërkesës
				Ndërtimi i aneksit të objektit të Komunës tek hapësira që shfrytëzohet nga zjarrfikësit	Komuna e Kaçanikut	300,000 euro	2026	Mos realizimi i projektit
4	Hapësirë e vogël arkivuese	4.1	Zhvendosja e dokumentacionit arkivor	Zhvendosja e dokumentacionit arkivor në pjesën e bodrumit të Komunës	ZKK dhe DAP	-	Q1-2024	-
				Skanimi i planeve. 1. Inventarizimi i planeve të realizohet nga ZKK dhe të dorëzohet kërkesa për skanim në AKK. 2. Skanimi dhe gjeoreferencimi i planeve realizohet nga AKK.	ZKK dhe AKK	-	Q3-2024	-
5	Mungesa e resurseve njerëzore	5.1	Të punësohet një zyrtar gjeodet	1. Kërkesa nga Drejtori tek zyra e burimeve njerëzore (zyra e personelit). 2. Hapja e konkursit dhe procedurat e prokurimit	ZKK dhe Zyra e personelit	715 euro për muaj	Q2-2024	Mos aprovimi i kërkesës
		5.2	Të punësohet një zyrtar (jurist) për përpunim të lëndëve në SIKTK	1. Kërkesa nga Drejtori tek zyra e burimeve njerëzore (zyra e personelit). 2. Hapja e konkursit dhe procedurat e prokurimit	ZKK dhe Zyra e personelit	545 euro për muaj	Q2-2024	Mos aprovimi i kërkesës
		5.3	Të punësohet një zyrtar (arkëtar)	1. Kërkesa nga DAP tek zyra e burimeve njerëzore (zyra e personelit). 2. Hapja e konkursit dhe procedurat e prokurimit	DAP dhe Zyra e personelit	506 për muaj	Q2-2024	Mos aprovimi i kërkesës
6	Resurset teknologjike	6.1	Paisja me 7 kompjuterë	Kërkesa nga Drejtori i ZKK-së tek Drejtoria e Administratës	ZKK dhe DAP	750x7 euro	Q1-2025	
		6.2	Printer dhe skaner të kualitetit të lartë	Kërkesa për printer dhe skaner të kualitetit të lartë dhe mirëmbajtje të tyre tek kompania e kontraktuar. Nëse kërkesa nuk merret parasysh atëherë ZKK i drejtohet AKK-së që të ngrit çështjen në nivel të Ministrisë	ZKK - AKK	-	Q2-2024	Pa përgjegjësi nga operatori ekonomik

7	Proceset e punës	7.1	Rekomandohet që të bëhet kërkesë në AKK që librat e ndërrimeve dhe hipotekave të mos plotësohen në mënyrë fizike.	Kërkesa nga ZKK në AKK	AKK	-	Q1-2024	-
		7.2	Kërkesë në AKK, që Qendra për Punë Sociale të ketë qasje në SIKTK, në mënyrë që vet të kërkojnë të dhëna në SIKT e të mos ketë kërkesa për verifikim çdo 6 muaj.	Kërkesa nga ZKK në AKK	AKK	-	Q1-2024	-
		7.3	Rekomandohet që të analizohet mundësia që një zyrtar i ZKK-së të merret vetëm me procesin e shpronësimit dhe legalizimit duke bërë kontrollin e kualitetit detaj dhe të regjistroj njësitë në SIKTK.	Ri-organizmi i stafit nga Drejtori	ZKK	-	Q2-2024	Mos aprovimi i kërkesës për staf shtesë
		7.4	Të realizohet interoperabiliteti mes SIK dhe SIKTK	Interoperabiliteti mes SIK dhe SIKTK	AKK dhe Ministria e Administratës	-	Deri në fund 2024	
		7.5	Në E-kioskat e Komunës, duhet të futen edhe shërbimet e kadastrit përkatësisht produktet bazike si çertifikata e pronësisë	Kërkesa e DAP dhe ZKK në AKK	DAP, ZKK dhe AKK	-	Q2-2024	-

PJESA LIGJORE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Neni 3.5 i LRDP përcakton se ZKK-ja duhet të bëjë regjistrimin e të drejtës mbi pronën e paluajtshme, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës së pranimit të kërkesës për regjistrim dhe lidhur me të do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës. Vendimi për regjistrim nga ana e ZKK-së në disa raste nuk lëshohet brenda afatit të paraparë ligjor brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, për shkak të mungesës së stafit.	Njëjtë si në pikën 5.2	Njëjtë si në pikën 5.2	Njëjtë si në pikën 5.2	Njëjtë si në pikën 5.2	Njëjtë si në pikën 5.2	Njëjtë si në pikën 5.2
2	Neni 7 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve përcakton se çdo person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare dhe çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilëndo gjuhë zyrtare. ZKK-ja lëshon aktvendime vetëm në gjuhën shqipe.	Për përkthime të njoftimeve të ZKK-së në gjuhën serbe dhe përkthimit të vendimeve individuale (nëse ka kërkesë nga pala) të sigurohet koordinimi ZKK/DAP dhe zyrtarit përgjegjës për përkthime	Të referohen për përkthim nga ZKK në DAP njoftimet dhe vendimet individuale (nëse ka kërkesë nga pala)	Drejtori i ZKK-së/Drejtori i DAP-së/Zyrtari përgjegjës për përkthime	-	Q1 2024	-
3	LRDP përcakton që çdo ZKK të mbajë tabelën e shpalljeve publike ku afishohen njoftimet e kërkesave për regjistrim për të paktën pesë ditë pune përpara nxjerrjes së vendimit që lejon regjistrimin. Njoftimi duhet të përmbajë: adresën e pronës, dhe nëse është e mundur, numrin e ngastrës kadastrale; të dhënat për personin prej të cilit bëhet bartja e të drejtës mbi pronën; të dhënat për personin që me regjistrim e fiton të drejtën mbi pronën; të drejtën që duhet të regjistrohet; dhe datën deri kur çdo palë e interesuar mund të paraqitë kundërshtimin të ZKK. ZKK aktualisht nuk e publikon shpalljen publike së paku 5 (pesë) ditë pune para nxjerrjes së vendimit me të cilin autorizohet regjistrimi i të drejtave siç kërkohet nga LRPP, me ç'rast ZKK-ja e publikon njoftimin publik vetëm pas nxjerrjes së vendimit.	Aktiviteti rekomandon nga AKK ose ZKK që të shtoj në diapozitivin e Aktvendimit për aprovim të kërkesës për ndryshim të pronarit edhe një paragraf që thotë se 'Ky vendim hynë në fuqi pas mbylljes së shpalljes publike'.	Është shtuar paragrafi në Aktvendim për aprovim të kërkesës për ndryshim pronari dhe ka filluar së aplikuari automatikisht për të gjitha ZKK-të nga data 11/12/2023	AKK	-	Q4 2023	Projektligji për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme nuk e kërkon më shpalljen publike
4	ZKK-ja, në shumicën e rasteve, nuk i regjistron njësitë e reja të parcelave brenda 3 (tre) ditëve të punës pas pranimit të kërkesës për regjistrim sipas udhëzimeve të AKK-së.	Të verifikohet nëse afati parashihet në Kornizën e Punës së AKK-së apo në Udhëzim Administrativ, në bazë të të gjeturave të zgjatet afati prej 3 (tre) në së paku 7 (shtatë) ditë	Verifikimi i kornizës rregullative	AKK	-	Q1 2024	Afati mund të rishikohet me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme (pasi të hyj në fuqi).

Barazia gjinore dhe përfshirja sociale

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	<p>Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore. Të shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të përfshihet në akte noteriale e drejta e pronësisë të regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve.</p>	<p>Zyrtarët komunalë të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Agjencia për Barazi Gjinore ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjeroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cenueshme), etj.; Përfshirja e Organizatave e Shoqërisë Civile dhe përkrahja e tyre nga donatorët e ndryshëm, Qeveria, Komuna.</p>	<p>Organizimi I fushatës vetëdijësuese - Tryeze diskutimi me akterë të ndryshëm -Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese, faqe te komunës, mediat, rrjete sociale etj. -Ligjërata vetedijësuese me nxënësit e shkollave të mesme për rëndësinë e të drejtave pronësore. - Takime informuese me qytetaret në qytet dhe vende rurale përmes përfaqësuesve të këshillave lokale.</p>	<p>Zyra e Kryetarit, - ZBGJ, -ZKK, - Drejtoria e Arsimit, Grupi i Grave Asambleiste</p>	<p>500 euro në vit</p>	<p>Prej Marsit 2024</p>	<p>Mungesa e planifikimit te buxhetit (2024), mospjesëmarrja e kënaqshme e qytetareve ne aktivitete</p>
2	<p>Duhet të krijohen masa dhe të ndermirën veprime të veçanta për mbështetjen e grave dhe të rinjve për zhvillim te qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal, me qëllim te fuqizimit social si dhe parandalimit të dhunës në baza gjinore.</p>	<p>Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja; Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të pajisjeve prodhuese dhe përpunuese, gjithashtu edhe në fushën e bujqësisë: subvencionimin me bagëti apo pajisje për gratë në bujqësi; Të shikohen mundësitë e prioritizimit (gjatë poentimit) të aplikonte të të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve gjatë ndarjes se subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë. Për të rinjtë: mbështetje në start up biznese.</p>	<p>Planifikimi i hershem i buxhetit ne baza vjetore nga DZHE, mbi parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Te zbatohet LBGJ dhe masat e veçanta në implementimin e ndarjes së subvencioneve në komunë.</p> <p>Të organizohen sesionet informuese për plotësimin e dokumentacionit (p.sh. përgatitja e biznes planit dhe dokumenteve përcjellëse).</p>	<p>Zyra e Kryetarit, DZHE, DBZHRP, DF, DKRS, ZGBJ.</p> <p>DZHE, DBZHRP, DF, DKRS dhe ZGBJ.</p>	<p>40,000 euro (me mundësi të rritjes së buxhetit nga mjetet e bartura nga rishikimi i buxhetit)</p> <p>500 euro në vit</p>	<p>Duke filluar nga Qershori 2024</p> <p>Q2 dhe Q3 çdo vit</p>	<p>Mungesa e buxhetit</p> <p>Mungesa e buxhetit</p>

3	Nxitja e debatit social nga shoqëria civile dhe zyrat për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshirë drejtorët dhe përfaqësuesit e zyrave të ndryshme në komune, si dhe asamblistëve, për t'i informuar gratë dhe burrat për rëndësinë e realizimit të së drejtës në trashëgimi.	Informata rreth legjisllacionit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cënueshme. Ngritja e vetëdijes të burrave për të drejtat pronësore të grave.	Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunal që të ndërmarrin fushata vetëdijësuese, me theks të veçantë në viset rurale. Organizimi i fushatës vetëdijësuese: - Tryezë diskutimi me akterë të ndryshëm, -Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese, faqe të komunës, mediat, rrjete sociale etj. -Organizimi i takimeve informuese me qytetarët në qytet dhe vende rurale përmes përfaqësuesve të këshillave lokale dhe Bashkësisë Islame.	Zyra e Kryetarit, DGJKP, ZBGJ.	500 euro	Duke filluar nga Marsi 2024	Mungesa e planifikimit të buxhetit (2024), mospjesëmarrja e kënaqshme e qytetarëve në aktivitete.
4	Të ngritet qasja e personave me nevoja të veçanta në shërbimet komunale që lidhen me pronë e kadastër.	Problemi qëndron te personat me të pamur të dëmtuar dhe me probleme me dëgjim.	Të ndahet buxheti për mjetet që do të bëjnë lehtësimin e qasjes për persona me probleme me të pamur dhe probleme me dëgjim.	Zyra e Kryetarit	2,000 euro	Nga qershori, me planifikim buxhetor të përfshihet në buxhetin për vitin 2025.	Mungesa e buxhetit, mungesë e profilit përkatës për të mbuluar këto nevoja.
5	Te shqyrtohet mundësia e lirimit nga tatimi në pronë për 50%, për periudhën 2 vjeçare kur prona regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve.	Vendimi nga asambleja komunale për masën afirmative.	Të bëhet analiza e kostos dhe ndikimit në të hyrat buxhetore përmes tatimit në pronë.	Kuvendi Komunal, DF dhe ZKK.	4,500-5,000 euro	Analiza e kostos të bëhet nga Janari deri në Qershor, kur fillon planifikimi i buxhetit për vitin pasues.	Vërtetimi i ligjshmërisë me MF dhe MAPL, si dhe zvogëlimi i të hyrave nga tatimi në pronë.
		Të identifikohet numri i pronave të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve.	ZKK	-	Q2 2024		
		Të bëhet fushata vetëdijësuese pasi masa të hyjë në fuqi.	ZKK, DF dhe ZBGJ	1,000 euro	Q3 dhe Q4		